



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**ZL.Anr.255/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevcu anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesat e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), paraqitur kundër Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), për shkak të vendosjes së posterave në rrugë publike, për Zgjedhjet Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 20.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**PRANOHEN** si të bazuara ankesat e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), ZL.Anr.255/2017, ZL.Anr.256/2017, ZL.257/2017 të datës 19.10.2017, kështu që Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 800.00 (tetëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

### A r s y e t i m

PZAP-i, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat ZL.Anr.255/2017, ZL.Anr.256/2017 dhe ZL.257/2017 të datës 19.10.2017 dhe i trajton si një ankesë evidentuar me shenjën ZL.Anr.255/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve ankimore, dhe për të tri ankesat vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Me datën 19.10.2017, PZAP-i ka pranuar tri ankesa: ZL.Anr.255/2017, ZL.Anr. 256/2017, ZL.Anr. 257/2017, nga subjekti politik PDK, dega në Prizren. Në ankesën e parë PDK ka theksuar se subjekti politik LVV, ka vendosur një njoftim me mbishkrim “Ndej me Vullnetar” në Qendër Historike të Prizrenit, afër Kishës. Më tej ka theksuar se ky veprim është në kundërshtim me Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit, ndërsa në ankesat Anr.256/2017 dhe Anr.257/2017, kandidati për anëtar të Komunës së Prizrenit Lulzim Morina nga radhët e subjekt politik LVV, ka vendosur postera në vende publike-në shtyllat elektrike, të fshatit Lubizhd Komuna e Prizrenit.

Këto veprime sipas pretendimeve në ankesë janë në kundërshtim me LZP dhe me Rregullat Zgjedhore.

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në përgjigjen në ankesë të datës 20.10.2017, theksoj se menjëherë pasi që ka pranuar urdhrin nga PZAP-ja, ka ndërmarr masat përmirësuese lidhur me këto çështje dhe ka larguar njoftimin/posterat e vendosur në shtylla elektrike, po ashtu ka theksuar se i ka informuar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e saj për dispozitat e Kodit të Mirësjelljes së Subjekteve Politike dhe nevojat për të zbatuar

dispozitat e tij. Andaj LVV ka ndërmarr të gjitha masat për të evituar shkeljet e mundshme nga anëtarët, mbështetësit apo kandidatët për zgjedhjet lokale.

Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur 5 fotografi ku shihet se janë larguar fotografit nga vendi ku ka ndodhur shkelja.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesat janë të bazuara**

Nga fotografitë e ofruara si provë në ankesë ZL.Anr.255/2017 shihet qart se LVV ka vendosur një njoftim në shtyllë elektrike me mbishkrim “Ndej me Vullnetar” në Qendër Historike të Prizrenit, afër Kishës si dhe në ankesat Anr.256/2017 dhe Anr.257/2017, kandidati për anëtar të Komunës së Prizrenit Lulzim Morina, nga radhët e subjekt politik LVV, janë vendosur në shtylla elektrike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugë publike.*

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat për rastin: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalët, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se LVV, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marr subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e LVV shihet qart se ka ndërmarr masat për evitimin e shkeljes së supozuar. Ndërmarrja e masave përmirësuese ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli po ashtu vlerësoi, se dënimi i shqiptuar ndaj subjektit në fjalë do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.255/2017 më datën 20.06.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
Gylden Sylejmani



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.